

VENDIM
Nr.712, datë 24.10.2007

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE NR.317, DATË 30.9.1947 “PËR KRIJIMIN E NDËRMARRJES MINERARE TË QYMYRGURIT, ME QENDËR NË TIRANË”, NR.304, DATË 15.7.1949 “PËR KRIJIMIN E NDËRMARRJES MINERARE SHTETËRORE TË QYMYRGURIT, MEMALIAJ”, NR.236, DATË 14.6.1957 “PËR KRIJIMIN E NDËRMARRJES SHTETËRORE TË HEKUR-NIKELIT, PISHKASH”, NR.403, DATË 8.10.1957 “PËR KRIJIMIN E NDËRMARRJES SHTETËRORE TË QYMYRGURIT, PISHKASH” DHE NR.339, DATË 12.10.1962 “MBI KRIJIMIN E NMSH HEKUR-NIKELI, GURI I KUQ”, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 31 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimeve nr.317, datë 30.9.1947 “Për krijimin e ndërmarrjes minerare të qymyrgurit, me qendër në Tiranë”, nr.304, datë 15.7.1949 “Për krijimin e ndërmarrjes minerare shtetërore të qymyrgurit, Memaliaj”, nr.236, datë 14.6.1957 “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore të hekur-nikelit, Pishkash”, nr.403, datë 8.10.1957 “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore të qymyrgurit, Pishkash”, dhe nr.339, datë 12.10.1962 “Mbi krijimin e NMSH hekur-nikeli, Guri i Kuq”, të Këshillit të Ministrave.

2. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për nxjerrjen e akteve nënligjore, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha